

# Gjekë Marinaj ambasador i kulturës shqiptare në ShBA



Gjekë Marinaj ka lindur në katund të Kastratit të M. Madhe në vitin 1965 dhe banon në Richardson të Texasit të SHBA, ku është vendosur që në vitin 1990, kur u arratis nga Shqipëria për motive Politike. Është diplomuar në institutin mjeksor ASPT, dhe në vitin 1997 ka mbaruar kolegjin Brookhaven, për shkencë të përgjithshme. Aktualisht vazhdon vitin e tretë në Universitetin UTD për artet e letërsisë Botërore me nëndegë Gazetarinë. Më 26 nëntor të vitit 1999 ka fituar çmimin "Pena e Artë" në një konkurs ndërkombëtar të poezisë që organizohet një herë në vit, nga Universitetet Amerikane. Po kështu ai është botuar në antologjinë "Best poems of the 90s" (Poezitet më të mira të viteve 90), në vitin 1998. Ka botuar dy libra dhe dy të tjerë i ka në shtyp.

Që nga viti 1996 është botues i gazetës „Kohët e poetëve“, Shqip-Anglisht. Gjithashtu Gjek Marinaj ka një shtëpi botuese „Marinaj Publishing“, ku ka botuar emra të njohur të diasporës shqiptare.

Redaksia e gazetës „Malësia“ i uron malësorit, vëllait, e kolegut Gjek Marinaj jetë të gjatë, fat e lumturi, Zoti e ndihmoftë në krijimtarinë e tij si ambasador i kulturës virtuozë shqiptare në SHBA.

## Vetëdija metarealiste e një poetike

Është mjaft e vështirë të përcaktohen rrethanat jetësore që ngjizën dhe formuan brezin e ri të poetëve në poezinë shqipe. Nëse duhet kërkuar një farë ideje e përgjithshme artistike që i lidh poetët e rinj shqiptarë përmbi gjithë laryshitë e stileve, atëherë së pari mund t'a shënojmë gjakimin e saj pikërisht si ide të kulturës. Kjo sigurisht, nuk është ide abstrakte, porse ai realitet zanafilor i dukshëm, përmjet të cilit poetët e rinj-ata më seriozë dhe më të përgjegjshmit-ndriçojnë raportet e tyre ndaj natyrës dhe njeriut. Risia principiale e kësaj poezie qëndron në pasurimin me refleksione të dyta të shtresës së perceptimit, të drejtuar në atë materie të kulturës, pjesë e së cilës është vetë poezia. Në progresin artistik, i cili për një kohë të gjatë eci në rrugën e përvetësimit të të gjitha shtresave të reja të realitetit: shoqëria (sorealizmi), personaliteti (lirika intime), natyra (poezia e fshatit)-ngjau një kërcim i beftë i vetëdijes, dyzimi, përderisa në sferën e përvetësimit hyri një sistem i tillë i fuqishëm që përfshiu të gjitha anët e realitetit, si kultura. Me gjithë shumësinë e manierave dhe shkallëve të ndryshme të talentit, ajo që dallon është një farë stili i përpunuar i kësaj gjenerate, pëlhura figurative e ndërlikuar e cila herë tretet në ligjëratën e ngazëllyer lirike, herë intonacioni i përmbytur, i prirur shpesh në definicione aforistike.

Raportet e tilla, hera-herës eklektike, mbart dhe poetika e njerit prej poetëve më të talentuar të këtij brezi, ajo e Gjekë Marinajt, libri i parë i të cilit "Mos më ik larg", 1995 (megjithë pjekurinë poetike që nuk i përfill përcaktorët "i parë, i dytë, etj.) kaloi pa vëmendjen e merituar në periodikët e kritikës letrare në Shqipëri. E përmenda vëllimin e parë poetik të Gjekë Marinajt për arsye të thjeshtë se, sikundër ndodh me të gjithë poetët e spikatur, libri i parë është ai që, gjithsesi, parathotë konturet e ardhshme të poetit, ose siç qe shprehur H. L. Borhesi, "të gjitha embrionet e veprave të mia, do t'i gjeni në një libër të hollë poetik me emrin "Aromat e Buenos-Airesit". E përmenda edhe për një arsye tjetër, pse libri i parë i tij është ajo pika nga ku mund të shtjellohet filli i ndërlikuar i asosacioneve, që lindën në shtresëzime të ndryshme kulturash dhe realiteti, veçanërisht përsa i përket dinamikës së


perceptimit.

Poezia e vëllimit poetik "Infinit", konsolidon ato tipare të vëllimit të parë; ajo si rregull, është një poezi e përmbytur, jo sentimentale, priret për nga plastika e formës, porse jo nga ekspresioni subjektiv i gjendjes, kërkon qartësi lëndore kur i referohet një objekti dhe të fton më shumë tek arsyeja sesa tek përjetimi i përkorë, më saktë, të përjetimi i arsyes së vetë ndjenjës. Në poezitë e këtij vëllimi kohët dhe vendet çojnë ndërmjet vedi një dialog të tendosur: natyra dhe teknika, historia dhe botkrijimi, arti dhe përditshmëria-gjithshka që përbën kulturën shpërpjestuar në epoka të ndryshme, areale, gjini e zhanre, ato fokusohen në një pikë të tillë të optikës poetike sa shndërrohen në pjesë të së tërës.

E organizuar nga principe të fshakta ritmesh, dhe disa herë me vark të lirë verlibër, kjo poezi të jep ndjesinë e shqetësimit estetik, të humbjes së orientimit... Nuk është puna në vështirësitë e gjuhës, e cila në vargjet e Gjekë Marinajt arrin shpesh një ngjije të begatë figurative e të harmonishme, diç që të ndërmend figuracionin barok, porse ndjehet një mungesë e vetëdijshme, qendër e përhershme e stabile. Thelbi, sigurisht nuk është në temën e poezisë, porse pikërisht në subjektin e shprehjes, i cili mjeshtrërisht në lirikën e re fiksohet përtej kufijve të personalitetit autorial dhe njëkohësisht, si rezultat i të gjitha proceseve të rimishërimit dhe "depersonalizimit" dhe i cili nuk ka si të mos përftojë cilësitë e personalitetit transhental.

Nëse do bëja tentativë për të përcaktuar poezinë e Gjekë Marinajt brenda katalogut të drejttimeve të reja stilistike në poezinë e re shqipe, atëherë, më për shtat mendoj se do t'i shkonte termi "metarealizëm". Në materien poetike të Marinajt ne do të na bjerë në sy gjithandaj prirja për të zhveshur thelbin e atrofizuar të objektit, për të shpërfaqur thellësinë e tij metafizike. Këtë Marinaj e arrin duke patur në themel të perceptimit dhe aparatit meditativo-konceptual, jo hiperbolën apo litotën, si rëndom në traditën e poezisë shqipe, porse METABOLËN.

Metabolë-do të thotë "zhvendosje", "spositim", "përzjerje", kthesë për t'u përdorur në një tjetër mundësi.



Nocionin "metarealizëm" kur flitet për poezinë e Marinajt do t'a kuptojmë në mënyrë ambivalente.

Në nivelin filozofik-kemi të bëjmë me një realizëm meta-fizik, d. m. th. Realizëm jo i të dhënave fizike, porse i natyrës mbifizike të gjërave. Në nivelin stilistik-të Marinaj kemi realizmin meta-forik, që ndërkalon nga ngjashmëria e kushtëzuar e sendeve në pjesmarrjen e tyre reale të ndërsjelltë, d. m. th. Nga metafora në metabolë. Modeli i metabolës në artin e lashtë mitologjik është metamorfoza.

Metabola-është një botë e tërë unike, e pandashme në dysh, porse e aftë të hapë në vetvete një shumësi dimensionesh. Metabola hapet në anën e përtejme të metaforës, si një realitet tjetër në të cilën metafora mundet vetëmse të aludojë në mënyrë të kushtëzuar. Në vend të ngjashmërisë, metabola e Marinajt ligjëron si bashkëpjesmarrëse e botërave të ndryshme e barazdrejtuar në autenticitetin e vet. Sipas principit të metabolës, të Marinajt zgjerohet sfera e kutpimeve të drejtpërdrejta, në funksion të asaj, që si kuptimi "figurativ", si ai përfytyruet, bëhet i drejtpërdrejtë në disa rrafshes semantike njëherësh. Kësisoj asosacionet abstrakte në dukje të parë, bëhen në poezinë e Marinajt pjesë përbërëse të një realiteti që zgjerohet.

Dhe së fundi metafora-është gadishmëria për të besuar

çudinë, kurse metabola-mundësia për të prekur e perceptuar atë.

Metarealizmi që aplikua në karakterizimin e poezisë së Marinajt, (në ndryshim nga "realizmi" që ka për objekt vetëmse një nga reletetet)-përmbyll në vetvete një shumësi relesh, të lidhura përmjet z h v e n d o s j e s h metabolike të pandërprera.

Metarealizmi i Marinajt i referohet në trasfigurimin poetik jo nënvetëdijes, por mbivetëdijes, ai nuk e deh shqisën e perceptimit poetik, por e sjell në gjendjen e esëllit të arsyes

krijuese.

Kjo mbivetëdije përshkon të gjithë vëllimin e Marinajt "Infinit" duke iu drejtuar temave metafizike të përjetshme: jeta, vdekja, Zoti, dashuria dhe në mënyrë të veçantë, (çka është karakteristike për vetëdijen fenomenologjike) përjetimit të kategorisë metaforike të kohës.

Pikërisht kur Marinaj u kthehet temave të tilla, kemi një tendencë maksimale të gjuhës, dhe së këndejmi, atë pikë inkadishencë që lind poezinë e valencës së lartë. Konceptonet filozofiko-matafizike, kur mishërohen me ligjëratën e përzetur gjuhësore arrijnë atë mpiksje të dëshiruar për poezinë, sa e bën atë të dallojë së një diamant mes ashklave e pluhërave të kulturës, aq të shumta në kohën tonë.

Një tjetër aspekt i poetikës së Gjekë Marinajt është "Arkivi Lirik", apo poezia e "Unit" efemer. Të tilla poezi kanë në thelb një konceptim të thjeshtë gjuhësor, qëllimi arrihet me mjete minimale leksikore, duke spikatur më fort efektin konceptual. Është kjo një linjë e preferuar e Marinajt, fillesën e së cilës e kemi parë në librin e tij të parë poetik "Mos më ik larg".

Kjo linjë e vazhduar në vëllimin e dytë "Infinit", ashtu si gjithë poezia shqipe e vjetër dhe e re, ruan në qendër të saj unin lirik, porse të Marinaj, kjo farë uni lirik është i dhënë në modusin e objekteve rrëshqitëse,

pamundësisë, mallit elegjik për atë "unë" të zhdukshme në strukturat e ngurta dhe të vrazhda të botës. Në këto poezi sundon nostalgjia dhe si rregull përshkojnë fillin e tretur të fëmijërisë dhe djalërisë nëpër viset e vendlindjes. Të tilla janë poezitë "Fëmijëria nuk është më aty", "Sepse një ditë të pashë me detin", "Shtëpia në Brrut" etj. Porse të gjitha këtyre fikcioneve Marinaj u avitet, siç shprehet në vargun e poezisë "Shqipëria".

Agron Tufa, Moskë 25 Prill 2000

## Kuajt që çuan Gjekë Marinën në Amerikë

Ishte një poezi e vetme e titulluar „Kuajt“ e cila u botua në një copë të gazetës „Drita“, aty nga fillimi i vitit 1990, e cila për nga madhësia e saj i bëri lexuesit të pyesin kush është, e nga është autori, deri atë ditë krejtësisht i panjohur, dhe kjo është më se e vërtetë. As kolegët e tij sikur nuk donin ta besonin se autori i kësaj poezie që u bë hymn për studentët e dhjetorit të 1990 në Tiranë ishte Djaloshi Malësor Gjekë Marinaj. I cili u lind në malet e Kastratit, zbriti në fushën e Bajzës ku jetoj për vite me radhë në një shtëpi kasolle, e në verferinë e tejskajshme që të sillnin vitet e „ndritura“ të Partisë. Gjeka nuk u mundonte, duronte dhe urrejtjen e shprehte me vargje, me armën e fortë të poezisë, ashtu në luftë me varferinë arriti të mbarojë shkollën e mesme teknologjike në Shkodër, dhe menjëherë pas botimit të poezisë „Kuajt“ Gjeka vihet në shënjestër të sekretarëve të Komitetit të Partisë Punës në Shkodër të kallepit Gjorgj Grabova. Dhe Gjeka Zgjodhi rrugën e rrezikshme të „Tradhëtisë“ ndaj atdheut. Me këtë rast po botojmë Poezinë „Kuajt“ e cila e çoi Gjekë Marinën në Amerikë. REDAKSIA

## Kuajt

Tërë jetën duke vrapuar rrimë  
Shohim veç përpara  
Ç'behët prapa s' duam t'ia dimë  
Ne nuk kemi emër  
Të gjithëve kuaj na thonë  
Nuk qajmë  
Nuk qeshim  
Heshtim  
Dëgjojmë,  
Hamë atë që na japin,  
Ecim nga na thonë  
Asnjë nga ne s'është mendjehollë  
Kush qe kalë mbreti  
Posti qe i lartë  
Kush qe kalë princeshe  
I bënë shalë të artë  
Kush qe kalë fshatari  
Pat samar me kashtë  
Kush qe kalë i egër  
Tërë jetën fjeti jashtë  
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para  
njeriut!